

5.1 RREGULLIMI I FONTIT

Për tekstin që shfaqet në ndërfaqen e përdoruesit (shfletues, dritare për kërkim, paraqitës) ju mund të ndryshoni llojin e shkrimit (fontin) dhe madhësinë e tij.

Procedura

1. Përzgjidhni metodën **Sistemi / Parametrat / Rregullimi i fontit**.

Hapet dritarja **Rregullimi i fontit**, në të cilin ndryshohet fontin dhe madhësia e tij.

2. Tek "Fonti" dhe "Madhësia" përzgjidhni vlerën që dëshironi.

Tek "Fonti" ndodhen të gjitha llojet e fontit të instaluar në kompjuterin tuaj, ndërsa tek "Madhësia" madhësitë e fontit. Madhësia e fontit shprehet në pika (pt).

Pas përzgjedhjes nga lista, teksti *Shembulli i printimit* shfaqet në fontin e dhe madhësinë e përzgjedhur.

Për të rikthyer fontin e paracaktuar (*Arial Unicode MS*) dhe madhësinë (12) klikoni në butonin **Paracaktuar**.

3. Klikoni butonin **Në rregull**.

Fonti i ri është i dukshëm menjëherë, mirëpo për bashkërendim me programin COBISS3, pas ndryshimeve të bëra duhet të mbyllni dhe të hapni prap programin.